

dhe ripërtëritjen shpirtërore dhe udhërrëfimim që fitohen vetëm nëpërmjet të mësuarit dhe të vënies në jetë të parimeve të ungjillit të Shpëtimtarit.

Shlyerja e Jezu Krishtit siguron pas-truesin e nevojshëm për të na bërë të dëlirë dhe të pastër, balsamin qetësues për të na shëruar plagët shpirtërore e për të na e hequr fajin dhe mbrojtjen që na aftëson për të qenë besnikë në kohë si të mira ashtu edhe të këqija.

### E Vërteta Absolute Ekziston

Juve, anëtarëve të familjeve dhe miqve që nuk jeni anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, unë jam përpjekur t'ju shpjegoj arsyet thelbësore përse ne jemi misionarë.

E vërteta absolute ekziston në një botë që gjithnjë e më shumë e shpërfill dhe e mohon konceptin e absolute. Në një ditë të ardhshme, “[do] të përkulet çdo gju” dhe “çdo gjuhë [do] të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë At[it]” (Filipianëve 2:10–11). Jezusi, Krishti, në mënyrë absolute është Biri i Vetëmlindur i Atit të Amshuar. Si anëtarë të Kishës së Tij, ne dëshmojmë se Ai jeton dhe Kisha e Tij është rivendosur në plotësinë e saj në këto ditë të mëvonshme.

Ftesat që ju drejtojmë për të mësuar rreth mesazhit tonë dhe për ta vënë atë në provë, janë si rrjedhim i ndikimeve pozitive që ungjilli i Jezu Krishtit ka pasur në jetët tona. Nganjëherë mund të jemi të sikletshëm ose të vrazhdë apo këmbëngulës në përpjekjet tona. Dëshira jonë e thjeshtë është të ndajmë me ju të vërtetat që kanë vlerën më të madhe për ne.

Si një prej Apostujve të Zotit dhe me tërë energjinë e shpirtit tim, jap dëshmi për qenien hyjnore dhe realitetin e Tij. Dhe ju ftoj “ejani e shikoni” (Gjoni 1:39), në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Tomas S. Monson

## Kur Prapë të Takohemi

*I përsiatshim të gjitha të vërtetat që kemi dëgjuar, dhe na ndihmofshin ato që të bëhemi dishepuj më të guximshëm.*

Vëllezërit dhe motrat e mia, kemi përjetuar dy ditë të lavdishme me mesazhe të frymëzuara.

Zemrat tona janë prekur dhe besimi ynë është forcuar ndërsa kemi marrë nga shpirti që ka qenë i pranishëm gjatë sesioneve të kësaj konference. Ndërsa e mbyllim [konferencën], ne e falënderojmë Atin tonë Qiellor për bekimet e Tij të shumta për ne.

Jemi lartësuar dhe frymëzuar nga muzika e bukur që na është ofruar gjatë sesioneve. Lutjet që janë

dhënë, na kanë çuar më pranë qiellit.

Më lejoni të shpreh falënderimet e përzemërta të mbarë Kishës për Vëllezërit tanë që janë liruar nga thirrjet në këtë konferencë. Do të na marrë malli për ta. Ndhimesa e tyre në veprën e Zotit ka qenë e pamasë dhe do të ndihet nëpër brezat që do të vijnë.

U ktheshim në shtëpi me një vendosmëri në zemrat tona që të jemi pak më të mirë nga sa kemi qenë në të shkuarën. Qofshim pak më të sjellshëm dhe më të matur. U drejtojmë





**Nga Linda K. Barton,**  
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhimës

me ndihmesë jo vetëm ndaj bashk-anëtarëve tanë, por edhe ndaj atyre që nuk janë të besimit tonë. Ndërsa shoqërohemi me ta, e tregofshim respektin tonë për ta.

Ka nga ata që ndeshen çdo ditë me sfida. Le t'u drejtojmë atyre shqetësimin tonë, si edhe një dorë ndihmëtare. Teksa kujdesemi për njëri-tjetrin, ne do të bekohemi.

I kujtofshim të moshuarit dhe ata që nuk lëvizin dot jashtë shtëpisë. Teksa gjejmë kohë që t'i vizitojmë, ata do ta dinë se i duan dhe i çmojnë. E ndjekshim porosinë që të "ndihmojmë" të dobët, ngr[emë] duart që varen poshtë dhe forcojmë gjunjtë e këputur<sup>1</sup>.

Qofshim ne njerëz me ndershmëri dhe integritet moral, duke u përpjekur të bëjmë gjënë e drejtë në të gjitha kohët dhe në të gjitha rrethanat. Qofshim ne pasues besnikë të Krishtit, shembuj drejtësie, duke u bërë kështu "pishtarë në botë"<sup>2</sup>.

Vëllezërit dhe motrat e mia, ju falënderoj për lutjet tuaja në emrin tim. Ato më forcojnë dhe më lartësojnë teksa përpiqem fort me gjithë zemër e forcë që të bëj vullnetin e Perëndisë dhe t'i shërbej Atij e t'ju shërbej juve.

Ndërsa largohemi nga kjo konferencë, i kërkoj bekimet e qiellit mbi secilin prej jush. Ju që jeni larg shtëpisë, u kthefshi të sigurt atje dhe e gjetshi gjithçka në rregull. I përsiatshim të gjitha të vërtetat që kemi dëgjuar, dhe na ndihmofshin ato që të bëhemi di-shepuj më të guximshëm nga sa ishim kur filloi kjo konferencë.

Derisa të takohemi sërish pas gjashtë muajsh, kërkoj që bekimet e Zotit të jenë mbi ju dhe, madje, mbi të gjithë ne, dhe e bëj këtë në emrin e Tij të shenjtë – madje Jezu Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë – amen. ■

#### SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 81:5.
2. Filipianëve 2:15.

## [Të] Përgatitur në një Mënyrë që Nuk Ishte Parë Ndonjëherë

*U përgatitshim për t'i marrë me denjësi ordinancat shpëtuese, pikë pas pike, dhe për t'i mbajtur me gjithë zemër besëlidhjet që i shoqërojnë ato.*

**K**ur vajza jonë më e vogël u kthye në shtëpi pas ditës së parë të saj në shkollë, e pyeta: "Si ia kalove?" Ajo u përgjigj: "Ishte mirë".

Megjithatë, të nesërmen në mëngjes kur e zgjova për në shkollë, ajo i mbloodhi krahët e saj dhe tha prerazi: "Unë shkova një herë në shkollë!" Me sa duket unë nuk e kisha përgatitur atë ose nuk ia kisha shpjeguar se të shkuarit në shkollë nuk ishte një ngjarje që ndodhte vetëm një herë, por që nga ajo pritej të shkonte në shkollë pesë ditë në javë për shumë, shumë vite.

Ndërsa e shqyrtojmë parimin e të qenit të përgatitur, përfytyroni me mua skenën që vijon. Jeni ulur në dhomën çelestiale të tempullit dhe vini re një numër nusesh dhe dhëndurësh që shoqërohen brenda dhe jashtë në mënyrë nderuese, ndërsa presin të martohen për kohën dhe gjithë përjetësinë. Një nuse hyn në dhomën çelestiale, dorë për dorë

me të dashurin e saj. Ajo ka veshur një fustan tempulli të thjeshtë por të bukur, dhe ka një buzëqeshje të qetë, paqësore e të ngrohtë në fytyrën e saj. Ajo është rregulluar mirë, por nuk ta tërheq vëmendjen. Ajo zë vendin e saj, vështron përreth dhe më pas, mbushet papritur me emocion. Duket sikur lotët e saj vijnë për shkak të drujtjes dhe nderimit që ajo ka si për vendin ku është, ashtu edhe për ordinancën e shenjtë që e pret atë dhe të dashurin e jetës së saj. Sjellja e saj duket se thotë: "Sa mirënjohëse jam që të jem sot në shtëpinë e Zotit, gati për të filluar një udhëtim të përjetshëm me një shok të dashur, të përjetshëm". Ajo duket e përgatitur për shumë më tepër se sa thjesht një ngjarje.

Mbesa jonë e bukur adoleshente, kohët e fundit la një shënim për mua mbi jastëkun tim, ku pjesërisht thuhej: "Një gjë që më bën përshtypje kur hyj në tempull, është shpirti paqësor dhe